



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 968/2 prot.,

Datë 23.04.2024

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “SULLOLLARI-KLIMA” SHPK në procedurën e prokurimit “*E hapur, marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 12 mujor*” me nr. REF: 98578-03-18-2024, me objekt: “Shërbim mirëmbajtje për impiantet e ngrohjes në objektet arsimore dhe Publike”, me fond limit 24 106 880 (*njëzet e katër milion e njëqind e gjashtë mijë e tetëqind e tetëdhjetë*) Lekë, pa TVSH, zhvilluar me datë 03.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë.

Ankimues:

Operatori ekonomik “SULLOLLARI-KLIMA” SHPK me NIPT K01529003M dhe adresë Tiranë, Rruga Muhamet Gjollesha, 71/3, Kati I.

Autoriteti Kontraktor:

Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë me adresë Rruga “5 Maji”, Godina 17, Tregu i Medresesë, Tiranë.

Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi A/2024/3995, datë 22.04.2024 dhe me Nr.968/2024 Prot., datë 22.04.2024 e operatorit ekonomik “SULLOLLARI-

KLIMA” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 12 mujor” me nr. REF: 98578-03-18-2024, me objekt: “Shërbim mirëmbajtje për impiantet e ngrohjes në objektet arsimore dhe Publike”, me fond limit 24 106 880 (njëzet e katër milion e njëqind e gjashtë mijë e tetëqind e tetëdhjetë) Lekë, pa TVSH, zhvilluar me datë 03.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “SULLOLLARI-KLIMA” SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “SULLOLLARI-KLIMA” SHPK.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

“1. Nuk plotëson pikën 2.1.2 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion në lidhje me akreditimin e entit certifikues që ka lëshuar certifikatat ISO 9001 dhe 14001 të paraqitura në SPE.

2. Nuk plotëson pikën 1 a), të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit pasi në Formularin përmbledhës të vetdeklarimit (Shtojca 9), është deklaruar numri i punonjësve por nuk janë deklaruar gjeneralitet për secilin nga punonjësit e kërkuar”.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 23.04.2024.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Anëtar

Kreshnik Ternova

Gjergj Mersini

Nënkryetar

Fiorent Zguro